



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
INSPEKTORATI SHTETËROR I MBIKËQYRJES SË TREGUT
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE

Nr. _____ Prot.

Datë ____ . ____ .2021

Lënda : Dërgohet raporti i monitorimit për 8 – mujorin e vitit 2021 për Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT).

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORISË SË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Tiranë

Në zbatim të Ligjit Nr. 137, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, Udhëzimit Plotësues Nr. 4 datë 25.01.2021 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2021” si dhe Udhëzimit Nr.22, datë 17.11.2016 “Për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore”, bashkëlidhur ju dërgojmë:

1. Raportin e monitorimit për 8 mujorin e vitit 2021 për Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut.
2. Relacion në lidhje me qëllimet, objektivat, treguesit e performancës të planifikuar dhe të realizuar si dhe realizimin e investimeve.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYEINSPEKTOR
LAVDRIM SAHITAJ

Konceptoi: B. Hamiti
Miratoi: E. Xhakollari
Datë 17.09.2021
Kopje (tre)

Raporti i Monitorimit për 8 mujorin e vitit 2021

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) ka për mision garantimin e sigurisë së produkteve për konsumatorët, të vendosura në treg dhe në shërbim/përdorim, nëpërmjet aktiviteteve mbikëqyrëse sipas legjislacionit përkatës në fuqi. ISHMT-ja është gjithashtu përgjegjëse për të monitoruar respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale si dhe të drejtave të tjera sipas fushës së veprimtarisë institucionale, objekt inspektimi sipas këtij vendimi.

DETYRAT

Në zbatim të VKM-së Nr.36 datë 20.01.2016 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e ISHMT”, fushat e përgjegjësisë së ISHMT-së janë si më poshtë:

- a) mbrojtja e konsumatorëve, sipas përcaktimit të ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve;
- b) mbrojtja e pronësisë industriale, sipas përcaktimit të legjislacionit për pronësinë industriale;
- c) garantimi i mbrojtjes dhe i respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, sipas përcaktimit të legjislacionit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to;
- ç) inspektimi metrologjik, sipas legjislacionit për metrologjinë;
- d) etiketimi për konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, sipas përcaktimit të legjislacionit për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji;
- dh) kontrolli i detergjentëve të vendosur në treg sipas dispozitave të ligjit për detergjentët;

OBJEKTIVAT KRYESORE

Objektivi kryesor:

Përmirësimi i sigurisë së produkteve për konsumatorët dhe respektimi i të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale.

Objektivi 1: Zbatimi i kërkesave ligjore nga subjektet konform legjislacionit në fuqi për ofrimin e produkteve, pajisje/instalime të sigurta për konsumatorin si dhe për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Objektivi 2: Rritja e ndërgjegjësimit të operatorëve ekonomikë mbi kriteret ligjore që duhet të zbatohen në fushën e sigurisë së produkteve joushqimore, pronësisë intelektuale si dhe të konsumatorëve mbi të drejtat e tyre.

INSPEKTIMET

Numri total i inspektimeve të planifikuara për vitin 2021 është **3.140**. Deri në fund të 8 mujorit të vitit 2021, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut ka realizuar **1.023** inspektime.

- Trajnime të ndryshme që kanë zhvilluar inspektorët pranë ambienteve të ISHMT-së, gjë që ka ndikuar në mos daljen e tyre në terren për inspektime.
- Angazhimi i inspektorëve në procesin e përditësimit të databazës së programit të inspektimeve.
- Ndryshimet ligjore të Ligjit të Metrologjisë i cili ka hyrë në fuqi në muajin Janar 2021.

BUXHETI DHE FINANCA

Në tabelën e mëposhtme jepen të dhëna të detajuara për 8 mujorin e vitit 2021 sipas llogarive kontabël dhe shpenzimeve për 8 mujor sipas llogarive përkatëse, në të cilën shihet edhe pakësimi i fondeve për disa llogari konkretisht për 600, 601,602 dhe 231 si dhe shtesë fondi për llogarinë 606.

	EMËRTIMI	PLANI BUXHETOR VJETOR FILLESTAR SHUMA (LEKË)	PLANI BUXHETOR VJETOR I KORREKTUAR SHUMA (LEKË)
Llogaria			
600	Paga	74.940.000	73.440.000
601	Sigurime Shoqërore e Shëndetësore	14.300.000	13.800.000
602	Shpenzime Korrente	20.200.000	20.156.000
606	Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individët	200.000	244.000
231	Investime	10.000.000	9.720.690
TOTALI		119.640.000	117.360.690
Llogaria		FONDET E SHPENZUARA PËR 8 MUJORIN E VITIT 2021 SHUMA (LEKË)	NË PËRQINDJE NDAJ PLANIT VJETOR TË KORREKTUAR (%)
600	Paga	44.470.495	60.5 %
601	Sigurime Shoqërore e Shëndetësore	7.426.061	53.8 %
602	Shpenzime korrente	10.791.634	53.5 %

606	Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individët	200.000	100 %
231	Investime	5.720.690	58.8 %
TOTALI		68.608.880	

- ❖ Nga llogaria 600 e ISHMT-së për pagat e punonjësve, është shpenzuar vlera **44.470.495** lekë ose **60.5 %** e fondit total të korrektuar për vitin buxhetor 2021.
- ❖ Nga llogaria 601 për Sigurimet Shoqërore Shëndetësore dhe Tatimet, është shpenzuar vlera **7.426.061** lekë ose **53.8 %** e fondit total të korrektuar për vitin buxhetor 2021.
- Pra, totali i shpenzimeve për personelin (600+601) për 8 mujorin 2021 është në vlerën **51.896.556** lekë nga **87.240.000** lekë ,pra **59.4 %** e fondit vjetor të ndryshuar.
- ❖ Nga llogaria 602 për mallra dhe shërbime, është shpenzuar për qira ambienti, pagesë uji, drita, kancelari, bojra për printera, materiale higjeno–sanitare, karburant, siguracion makinash, udhëtime brenda vendit etj, vlera **10.791.634** lekë ose **53.5 %** e fondit total të korrektuar për vitin buxhetor 2021.
- ❖ Nga llogaria 606 për transferta familjare dhe individë, është shpenzuar e gjithë vlera **200.000** lekë, pra **100%**.
- Pra, totali i shpenzimeve operative (602+606) për 8 mujorin 2021 është në vlerën **10.991.634** lekë nga **20.400.000** lekë , pra **53.8 %** e fondit vjetor të ndryshuar.

INVESTIMET

Për vitin 2021 për ISHMT me planin buxhetor të rishikuar investimet janë si më poshtme:

- **Kodi (M100465)** – “Blerje të pajisjeve dhe instrumentave për testim dhe inspektim në terren” ndryshuar me **Kod projekti (18AX706)** në vlerën **5.039.490** lekë me Tvsh. Kontrata është nënshkruar më 26.04.2021 si dhe është kryer ekzekutimi i pagesës prej **5.039.490** lekë.
Statusi i projektit : I realizuar.
- **Kodi (M100538)** – “Blerje pajisje kompjuterike” (kompjuterat dhe laptop) në vlerën **681.200** lekë me Tvsh. Ky investim është realizuar në vlerën **681.200** lekë me Tvsh. Ekzekutimi i pagesës së këtij investimi është kryer më datë 20.04.2021 pranë Degës së Thesarit Tiranë.

Statusi i projektit : I realizuar.

- **Kodi (M100227)** – “Blerje makine” në vlerën **4.000.000** lekë me Tvsh. Procedura e blerjes së makinës është anuluar nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara (ABP) me shkresën Nr. 1324 Prot., datë 23.07.2021, protokolluar në ISHMT me Nr. 571 /8 Prot., datë 28.07.2021

Statusi i projektit: Anulluar.

- Totali për “Shpenzime për investime” (231) për 8 mujorin 2021 është në vlerën **5.720.690** lekë nga **9.720.690** lekë, pra **58.8%** e fondit vjetor të ndryshuar.

TË ARDHURAT

Për 8 mujorin e vitit 2021 janë arkëtuar në buxhet , nga gjobat dhe asgjësimi i lodrave, vlera **6.188.913 lekë**.